Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-955
Datë: 08.10.2026

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), nxjerrë këtë:

VENDIM

Riakreditohet dhe rivalidohet Kolegji **"Pjetër Budi"**, me adresë: Lagja Aktash I, Rr. Gazmend Zajmi, Nr. 33, Prishtinë (dhe qendra e trajnimeve në Fushë Kosovë), për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 01.08.2026 deri më 31.08.2031, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

1.1. **Furrëtar,** Niveli III i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), Iloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 10 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit profesional për një vit kalendarik në total 4 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup është maksimalisht deri 15-16 kandidatë, që në total bëjnë rreth 60-64 kandidatë për një vit.

1.2. **Ndihmës Kuzhinier,** Niveli III i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), Iloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 10 kredi të AAP. Kolegji "Pjetër Budi" mund të realizojë procesin e aftësimit profesional për një vit kalendarik në total 4 grupe brenda vitit, duke organizuar nga një grup për çdo cikël trajnimi tre mujor. Numri i kandidatëve për 1 grup është maksimalisht deri në 15 kandidatë, që në total bëjnë deri në 60 kandidatë për një vit.

1.3. **Asistent Dentar,** Niveli IV i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), Iloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 14 kredi të AAP-së. Institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit profesional gjatë një viti kalendarik në gjithsej 3 grupe brenda vitit. Numri i kandidatëve për një grup është maksimalisht deri në 10 kandidatë, që në total bëjnë 30 kandidatë për një vit, **me kusht të funksionalizimit dhe dëshmimit të gatishmërisë së infrastrukturës, kabinetit praktik, pajisjeve, instrumenteve, materialeve dhe stacioneve të vlerësimit para regjistrimit të kandidatëve dhe fillimit të programit. Data e plotësimit 31.01.2027.** Gjatë pjesës praktike duhet të sigurohet organizimi në nëngrupe ose rotacione, kur është e nevojshme, për ushtrimin dhe vlerësimin individual. Përmbushja e këtyre kushteve verifikohet nga AKK-ja brenda afatit të përcaktuar.

1.4. **Teknik i Dhëmbëve,** Niveli IV i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), Iloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 16 kredi të AAP-së dhe 320 orë. Institucioni mund të realizojë procesin e aftësimit profesional gjatë një viti kalendarik në gjithsej 3 grupe brenda vitit. Numri i kandidatëve për një grup është maksimalisht deri në 10 kandidatë, që në total bëjnë 30 kandidatë për një vit, gjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit, **me kusht të përmbushjes së kërkesave për infrastrukturën dhe laboratorin praktik. Data e plotësimit 31.07.2027.**

2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesave të Kolegjit "Pjetër Budi" për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipeve të ekspertëve mbi validimin e kualifikimeve, si dhe raportet e ekipeve të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipet e ekspertëve pas shqyrtimit të dosjeve të aplikimit për kualifikimet: **Furrëtar (Niveli III), Ndihmës Kuzhinier (Niveli III), Asistent Dentar (Niveli IV)** dhe **Teknik i Dhëmbëve (Niveli IV)** sipas KKK, si dhe pas realizimit të vizitave në terren dhe hartimit të raporteve vlerësuese, i kanë proceduar të njëjtat për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 07.10.2026.

Rekomandimet përfundimtare të ekipeve të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionet për validim të kualifikimeve/moduleve; Aplikacioni për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues i kualifikimit; Raportet e Vetëvlerësimit; Vizitat në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente të tjera shtesë.

Për secilin prej kualifikimeve, për një vit kalendarik lejohen katër (4) grupe brenda vitit me nga 15-16 kandidatë, që në total bëjnë rreth 60-64 kandidatë për një vit. Kjo shifër reflekton kapacitetin aktual të institucionit për të pranuar dhe përkrahur kandidatët në kuadër të këtyre kualifikimeve. Megjithatë, theksohet se **kolegjit nuk i lejohet të regjistrojë kandidatë para se t'i plotësojë plotësisht kushtet e përcaktuara dhe të përfundojë procesi i renovimit të objektit në Fushë Kosovë.**

Pas trajtimit në detaje nga ekipet e ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizitat, ekipet e ekspertëve në raportet e hartuara dhanë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtat ia rekomanduan Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASH për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit: "Pjetër Budi"
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD së AKK